

Konkurrenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit në Kosovë



Prishtinë, 30 Qershor 2010

Më 8 Qershor, Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL) organizoi një Tryezë të rrumbullakët për mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencën, ku u prezantuan dy analiza po më te njëjtat tema: **“Mbrojtja e Konsumatorit: Korniza ligjore, sfidat në Kosovë dhe standardet e BE-së”** dhe **“Konkurrenca: Korniza ligjore dhe praktika në Kosovë krahas standardeve Evropiane”**. Këto analiza përmbajnë rekomandime për ndryshim të

legjislacionit në fuqi në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencës së lirë në vend.

Mbrojtja e Konsumatorit dhe Konkurrenca e lirë kanë qenë nga fushat më të kritikuar në Raportin e Progresit 2009 të Bashkimit Evropian për Kosovën. Në kuadër të fushës së konkurrencës, Komisioni Evropian në raportin e progresit vlerëson, *“Përveç pak progres në implementimin e politikave të anti-trustit, implementimi i përgjithshëm i politikave të konkurrencës është në fazën fillestare”*. Në analizën publikuar, IPOL rekomandon që të ketë ndryshim të ligjit për konkurrencën dhe përshtatja e tij me traktatet dhe rregulloret në fuqi të Bashkimit Evropian. Gjithashtu është e nevojshme ngritja e kapaciteteve të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, duke përfshirë ngritjen kuantitative dhe kualitative të personelit, sidomos në fushën juridike, zgjerimi i kushteve të punës dhe ngritja e buxhetit për aktivitete operative. Është e nevojshme që të ndërmerren fushata edukative për zbatimin e ligjeve që mbrojnë konkurrencën duke përfshirë fushata mediale, seminare, trajnime, udhëzues, etj. Më se e nevojshme është që të ngritën hetime ex-officio nga KKK për t'i hetuar sektorët strategjik të ekonomisë ku çmimet janë të ngurta dhe të njëjta nga pothuajse të gjitha kompanitë.

Në përgjithësi të drejtat e konsumatorit nuk respektohen dhe nuk janë mirëfilli të garantuara nga ligji aktual sepse ai nuk parasheh mekanizma të identifikuar qartë që merren me mbrojtjen e të drejtave të tyre, që do të lehtësonte ankimin e pakënaqësive dhe paraqitjen e rasteve kur të drejtat e tyre nuk respektohen. IPOL rekomandon që të ketë ndryshime në ligjin aktual për mbrojtjen e konsumatorit, si nga ana terminologjike, përcaktimin e çmimit final dhe përmirësimin e strukturës institucionale që merret me mbrojtjen e konsumatorit. Gjithashtu në analizë theksohet rëndësia që Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës ta ndërpresin ngarkimin e konsumatorëve me shpenzime shtesë për listën e detajuar të thirrjeve brenda periudhës së faturuar, dhe që Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit të procedojë kërkesë në PTK për reimbursimin e konsumatorëve që janë ngarkuar me atë. Është më se e nevojshme që Ministria e Arsimit dhe ajo e Tregtisë të bëjnë përgatitjen e planeve dhe programeve edukativo-arsimor, gjë që është edhe obligim ligjor i tyre.

NGJARJET E ARDHSHME:

Publikimi i raportit të tretë monitorues të EULEX-it

Publikimi i raportit për komunat e reja

PUBLIKIMET TONA:

EULEX: Në kërkim të identitetit (Raporti i vlerësimit të punës njëvjeçare të EULEX-it).

Analizë për ligjin e prokurimit publik

Konkurrenca në Kosovë

Mbrojtja e konsumatorit

Reforma e pushtetit lokal dhe sistemi zgjedhor

PROJEKTET TONA:

Politikat publike në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë

Fushata për ngritjen e vetëdijes kundër Korrupsionit

Ndërtimi i komunave të reja

Për ne: Instituti Ballkanik i Politikave punon për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë përmes politikëbërjes pragmatike që funksionon për mirëqenien e qytetarëve.

Si të na gjeni: Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL), Rr. Qamil Hoxha Nr.4/3, Prishtinë, Kosovë

Tel / +381 (0)38 220 552 www.policyinstitute.eu